



## Parimet për Riintegrimin e Luftëtarëve të Huaj Terroristë të Rikthyer (LHT)

### Hyrje

Më shumë se 30.000 njerëz nga 90 vende të ndryshme janë larguar nga atdheu i tyre për të marrë pjesë në luftëra të huaja, shpesh angazhuar në grupe të njohura aktive terroriste. Ky numër është në rritje, dhe vendet pa histori të mëparshme të luftëtarëve të huaj mund të zbulojnë se qytetarë të tyre janë pjesëmarrës aktivë në zonat e luftës. Ndërsa është e paqartë se sa prej tyre në fund të fundit do të kthehen në vendet e tyre të origjinës, ekziston një shqetësim ndërkombëtar në rritje në lidhje me kthimin e parashikuar të këtyre luftëtarëve të huaj terroristë (FTFs). Disa LHT mund të jenë zhgënjyer; të tjerë mund të kenë ikur; Akoma të tjerë mund të jenë kthyer për një arsye të veçantë. Individët e rikthyer në vendet e tyre do të kenë parë ose marrë pjesë patjetër në ngjarje traumatike dhe ka të ngjarë të mbajnë pikëpamje më ekstreme. Ndërsa Memorandumi Romak mbi Praktikën e Mira për Rehabilitimin dhe Riintegrimin e Shkelësve të Dhunshëm Ekstremistë i Forumit Global të Antiterrorizimit (GCTF) adreson se çfarë të bëhet me Shkelësit e Dhunshëm Ekstremistë, duke përfshirë LHT-të e rikthyer të cilët janë burgosur, shtetet mund të mos jenë në gjendje apo t'ju duket e pamundur ndjekja penalisht e të gjithë LHT-ve të tyre të rikthyer. Megjithatë, për të reduktuar mundësinë që këta individë t'i kthehen terrorizmit, qeveritë duhet t'i ndihmojnë ata të shkëputen nga aktivitetet e dhunshme dhe të riintegrohen me sukses në komunitetet e tyre pas rikthimit të tyre.

Ekzistojnë, natyrisht, një sërë faktorësh të ndërlidhur që rrisin vulnerabilitetin dhe sensibilitetin e individit për t'u tërhequr në aktivitetin e huaj terrorist. Shumë nga LHT-të e sotëm të cilët udhëtuan në Siri dhe Irak ishin individë të pambrojtur: të varfër, të paarsimuar, nga zona dhe rajone të marginalizuara, me pak njohuri mbi fenë. Shumë kishin përvojë të mëparshme me sistemin e drejtësisë penale, shpesh për krime apo probleme me drogën. Shumë vinin nga familje të ndara, me marrëdhënie jo fort të lidhura prindër-fëmijë. Përveç kësaj, shumë udhëtuan për të ndihmuar ndërtimin e një shteti të ri, pa patur qëllim përfshirjen në akte të dhunshme, por megjithatë u tërhoqën në konflikte të armatosura. Këto sfida duhet të plotësohen me një gamë të programeve që përfshijnë një gamë të gjerë të zbatimit të ligjit dhe të armëve sociale të qeverive kombëtare, si dhe komuniteteve lokale nga të cilat këto LHT të rikthyer vijnë.

Edhe pse programet duhet të përshtaten me kushtet lokale, kulturat dhe traditat ligjore, ndërsa ende përmbushin ligjet e zbatueshme ndërkombëtare dhe kombëtare, parimet e mëposhtme ofrojnë një set të plotë të praktikave që potencialisht mund të shërbejnë si bazë për politikën dhe programet e shteteve. Ashtu sikurse Kombet e Bashkuara vunë në dukje, programet e riintegritimit "duhet të trajtohen me kujdes në funksion të impaktit të tyre të drejtpërdrejtë në të drejtat themelore të njeriut, përfshirë të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes, fesë dhe mendimit, si dhe të drejtën për trajtim të drejtë në përputhje me Shtetin e së Drejtës." Fatmirësisht, ka fakte të bollshme se përgjigjet që shkelin këto të drejta mund, në fakt, të jenë kundër-produktive, të armiqësojnë ndjenjat e mosbesimit ndërmjet komuniteteve kryesore, dhe në fund të fundit, të forcojnë mbështetjen për grupet e dhunshme ekstremiste.

Kjo listë e parimeve është e pafund. Shtetet mund të zgjedhin të zgjerojnë ose modifikojnë listën për përvojat e tyre në këto zona, duke ndarë informacionin rreth përpjekjeve të tyre me shtetet e

tjera të interesuara. Të mësuarit më shumë për çfarë ka rezultuar e suksesshme ose ka dështuar, dhe pse, mund të ofrojë mësim të vlefshme si Qeveritë të mund të ndërtojnë apo përmirësojnë programet e tyre.

## **A. Struktura e Programit**

***Parimi # 1*** *Vendosja e qëllimeve dhe e objektivave të qarta për të identifikuar suksesin dhe dështimin.*

Vendosni se cilat janë rezultatet e pritshme të programit për matjen e suksesit dhe dështimit. Përdorni metodologji kuantitative dhe kualitative kërkimore dhe qasje psikologjike, sociale, dhe njohëse për të përcaktuar nëse një program siguron rezultatet e dëshiruara. Ekspertët në psikologji, fe ose psikiatri mund të zhvillojnë tregues të dobishëm për të treguar rezultatet e programit.

***Parimi # 2:*** *Standardet dhe praktikat e mira janë çelësi i ndërtimit të programeve të efektshme, të sigurta dhe pa probleme të riintegrit*

Kontakti fillestar me një LHT të rikthyer duhet të kërkojë ndërtimin e besimit dhe mbajtjen e një qëndrimi pozitiv ndaj autoritetit. Nëse nevojitet ndalimi i individit të rikthyer, duhet të ndiqet një bazë ligjore kuadër, e qartë dhe procedurale. Këto duhet të jenë në përputhje me detyrimet e të drejtave e njeriut dhe detyrimet ligjore ndërkombëtare, të përcaktojnë qartë institucionet dhe agjencitë e përfshira, si dhe rolet e tyre, përgjegjësitë dhe kompetencat përkatëse. Regresi ose recidivizmi i një LHT nuk nënkupton dështimin sistematik të sistemit; kjo punë është natyrshëm e paparashikueshme. Politikat e hartuara mirë dhe të fuqishme të riintegrit mund të ofrojnë një kuadër të fortë dhe një ekuilibër me pak përpjekje të suksesshme.

***Parimi # 3:*** *Kryerja e vlerësimeve efektive për të përcaktuar qasjen më të mirë për nevojat e programit të riintegrit.*

Programet duhet të hartohen duke patur në fokus individin. Të kuptuarit se përse LHT-të e rikthyer marrin rrugën e ekstremizmit të dhunshëm është thelbësore për hartimin e programeve të tyre të riintegrit. Vlerësoni se cilët individë janë kandidatë të përshtatshëm për programin dhe cilët nuk janë. Më pas, kandidatët e konsideruar të përshtatshëm duhet të vlerësohen më tej për të përcaktuar rrezikun dhe kërcënimin që ata paraqesin, dhe për të hartuar programin më të mirë për ta. Mësoni sa më shumë të jetë e mundur në lidhje me historikun vetjak të një LHT-je, historikun e tyre kriminal, tipare të personalitetit, ideologjisë dhe sjelljes. Vlerësoni motivimin e tyre për rikthimin, zbuloni se ku ata bien në spektrin midis krejtësisht të zhgënjyer dhe të radikalizuar dhe të inkurajuar më tej. Kryejini këto vlerësime rregullisht, për të informuar vendimet e menaxhimit (grupit drejtues) dhe problemet e sigurisë; vlerësoni efektet e strategjive të ndërhyrjes; zbuloni ndryshimet në qëndrimet e pjesëmarrësve; ose përshtatni strategjitë.

## **B. Elemente Bazë të Programit**

***Parimi # 4:*** *Përgatitja e komuniteteve për një program riintegriti dhe trajtimi i shqetësimeve të tyre legjitime që nga fillimi.*

Shtetet duhet t'i parapërgatisin anëtarët e komuniteteve me maturi para zyrtarizimit të programit të riintegritit dhe vendosjes së LHT-ve në mesin e tyre. Komuniteti lokal dhe drejtuesit fetarë duhet të vihen në dijeni për veçoritë, tiparet dhe dobitë e programit të propozuar të riintegritit duke iu përcaktuar qartë synimet dhe parametrat e programit. Këta drejtues duhet ta transmetojnë programin e propozuar në komunitet duke sqaruar edhe se si do të ruhet siguria dhe cili do të jetë roli i secilit pjesëtar të komunitetit, për tu bindur që çdonjëri ta kuptojë që siguria është elementi më i rëndësishëm në planin e riintegritit. Komunikimi efektiv i një çështje kaq delikate kërkon planifikim dhe qartësi në mendjet e përgjegjësve të programit, në materialet e shkruara që përgatisin shtetet dhe i shpërdajnë në popull dhe në informacionin specifik që iu përçohet komuniteteve që do të presin LHT-të e rikthyer. Rëndësi të njëjtë me procesin ka dhe dëgjimi dhe dhënia e përgjigjeve të duhura ndaj shqetësimeve legjitime të komunitetit. Shtetet duhet të marrin në konsideratë trajnimin me kujdes të një shtetasi, të cilit do t'i besohet detyra e zëdhënësit në komunitet, për të siguruar besim dhe hequr frikërat e komunitetit që nga fillimi dhe për të inkurajuar një program që kuptohet plotësisht nga të gjithë pjesëtarët e komunitetit se si kontributet e tyre mund dhe do të ndikojnë në sigurinë dhe mirëqenien e të gjithëve.

#### ***Parimi # 5 Sigurimi i strategjive për të fituar besimin dhe bashkëpunimin e komuniteteve.***

Përfshirja e familjeve, anëtarëve të komunitetit dhe organizatave të shoqërisë civile në zhvillimin e programeve për të riintegruar LHT-të e rikthyer mund të çojë më tej qëllimin e riintegritit të sigurt përsëri në një komunitet. Ofrimi i mbështetjes për komunitetet, dhe në veçanti ato grupe brenda komuniteteve që ka të ngjarë të kenë ndikim mbi LHT-të (p.sh., gratë, familjet, dhe udhëheqësit e komunitetit) mund të përbëjë ndryshimin ndërmjet LHT-ve të pranuar dhe të rikthyer në komunitet të cilët e kundërshtojnë dhunën dhe kthimin e tyre në grupet që mbështesin dhunën. Përcaktimi nëse LHT-të në programet e riintegritit do të integrohen në popullatën përreth ose do të strehohen në objekte të ndara, duke kërkuar mbështetje specifike praktike dhe financiare. Identifikoni ankesat midis palëve të ndryshme, merrni pjesë në gjetjen e zgjidhjeve, dhe fuqizoni komunitetet për t'i zbatuar ato. Qëllimi duhet të jetë krijimi i një rrjeti mbështetës rreth një LHT-je të rikthyer brenda dhe jashtë familjes dhe komunitetit të tyre.

#### ***Parimi # 6: Zbatimi i ligjit mund të luajë një rol të rëndësishëm në përpjekjet e suksesshme të riintegritit.***

Ekzekutuesit e ligjit mund të përgatisin një plan angazhimi të komunitetit për të ndihmuar në fitimin e besimit dhe vullnetit të mirë brenda komuniteteve dhe për të mbështetur partneritetet me udhëheqës dhe organizata lokale. Trajnojini dhe edukojini të gjithë ekzekutuesit e ligjit dhe oficerët për të kuptuar dhe trajtuar kompleksitetin e përpjekjeve për riintegrim. Trajtoni stafin e programit dhe profesionistët në dallimin e shenjave të radikalizimit, përgjigjuni në mënyrë përshtatshme ndaj kërcënimeve të mundshme ekstremiste, dhe komunikoni me LHT-të në mënyrë konstruktive duke shmangur konfliktet. Është e rëndësishme të mos paturit ndrojtje, jini profesionistë dhe siguronit që një LHT të ketë mbështetjen e familjes dhe komunitetit dhe që ky i fundit të mos bëhet padrejtësisht i varur nga anëtarët individualë të stafit të programit. Shtetet mund t'i shpjegojnë programet për të gjithë anëtarët e përfshirë duke kryer trajnime apo takime. Respektimi i shtetit të së drejtës dhe parandalimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut mbetet një problem kyç dhe nuk duhet të kufizohet vetëm në qendrat e paraburgimit.

### **C. Rolet e Pjesëmarrësve të Ndryshëm në Programe Riintegrimi**

***Parimi # 7: Programet e riintegritit duhet të përdorin një gamë të gjerë të ekspertëve ndërdisiplinorë, me koordinim të ngushtë ndërmjet zyrtarëve përkatës.***

Kombinoni një shumëllojshmëri të ekspertëve në një metodë shumë agjencish për të përmbushur nevojat e LHT-ve të rikthyer, dhe për të siguruar komunikim efektiv me individë radikalë. Psikologët, punonjësit socialë, dijetarët fetarë, ekspertët e përkujdesjeve të mëtejshme, shërbimet rinore, shërbimet e shëndetit mendor, ekzekutuesit vendorë të ligjit, dhe, në veçanti, anëtarët e familjes dhe përfaqësuesit e komunitetit janë të gjithë pjesë përbërëse të një programi të suksesshëm të riintegritit. Institucionet qeveritare dhe shoqëria civile duhet të punojnë së bashku për të planifikuar me kujdes, strukturuar, dhe koordinuar këto përpjekje për të maksimizuar efektivitetin e programit, duke siguruar se të gjithë ata të përfshirë përçojnë mesazhe të vazhdueshme për LHT-të. Identifikoni dhe emërtoni individët për të lehtësuar besimin dhe bashkëpunimin midis agjencive / entiteteve dhe me LHT-të individualë. Hartoni një plan strategjik komunikimi me rregulla dhe udhëzime të qarta mbi shkëmbimin e informacionit dhe reciprocitetit. Inkurajoni LHT-të të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e riintegritit të tyre, por siguroni që marrëdhëniet mes tyre dhe stafit të programit të mbeten korrekte, profesionale, dhe të institucionalizuara.

***Parimi # 8: Integrojini plotësisht psikologët dhe profesionistët e tjerë të shërbimeve sociale në procesin e riintegritit dhe inkurajoni LHT-të e rikthyer të marrin pjesë në programet e tyre.***

Psikologët mund të ndihmojnë në identifikimin e faktorëve që e bëjnë një individ të prekshëm ndaj ideologjisë së dhunshme dhe të cilët e motivojnë një LHT për t'u angazhuar në veprimtari terroriste. Ky informacion ndihmon në përcaktimin nëse një LHT i rikthyer përbën një kërcënim dhe në hartimin e një plani të individualizuar riintegritit. Psikologët mund të jenë posaçërisht të trajnuar për të kryer këtë lloj pune. LHT-të e rikthyer mund të kenë nevojë për përkujdes mjekësor ose psikologjik apo ndihmë të veçantë për t'u rikthyer në shoqërinë normale, e cila do të kërkojë mbikëqyrje dhe monitorim. Shkëmbimi i informacionit dhe mbledhja e pikëve të të dhënave është e paçmueshme për të parandaluar, penguar, dhe zbutur incidentet. Lidhni marrëveshje të qarta me departamentet e shërbimeve sociale, ekzekutuesit e ligjit, si dhe organizatat e shoqërisë civile se kush komunikon, çfarë, kujt dhe kur, sa i përket mbledhjes dhe shkëmbimit të informacionit. Një LHT duhet të kuptojë programin e riintegritit dhe çfarë ai përpiket të realizojë, si dhe duhet të ketë mundësinë për të komentuar rreth efektivitetit të tij dhe t'a përshtasë atë për nevojat e tij. Kjo do të inkurajojë një ndjenjë të pronësisë dhe do të nxisë interes në arritjen e suksesit. E dobishme për të gjithë mund të jetë edhe që një LHT të nxitet të ndihmojë të tjerë në programe të ngjashme.

***Parimi # 9: Pjesëmarrësit e programit, ekzekutuesit e ligjit, dhe anëtarët e shoqërisë civile duhet të kuptojnë procesin e riintegritit.***

Për të shmangur ndërprerjen e procesit të riintegritit, të gjithë pjesëmarrësit në kontakt me LHT-të e rikthyer duhet të trajnohen për sjellje profesionale, në të drejtat e LHT-ve, rregullat dhe përgjegjësitë, dhe se si të mbikëqyrin LHT-të duke përdorur teknika strikte, të drejta, dhe të qëndrueshme. Ushtrimet *tabletop*\* mund të rrisin diskutime të moderuara ndërmjet profesionistëve, duke qenë se ata shqyrtojnë rolin e aktorëve të ndryshëm dhe adresojnë çështje që lidhen me LHT-të në programet e tyre. Pjesëmarrësit mund të përfshijnë përfaqësues nga sfera diplomatike, politike, ushtarake, shoqëria civile, akademike, intelijenca, dhe komunitete të ekzekutimit të ligjit. LHT-të

duhet të jenë në gjendje të shohin zbatimin e drejtë dhe të barabartë të të gjithë ligjeve, për të rritur më tej besimin e tyre tek programi dhe tek ata të përfshirë në drejtimin e tij. Për të qenë efektiv, të gjithë personat e përfshirë me riintegrimin e LHT-ve duhet të kenë besimin e atyre LHT-ve. Shtetet do të përfitojnë nga fuqizimi i shoqërisë civile. Shoqëria civile mund të ketë mjete më të mira për përballimin e këtyre çështjeve, por këto të fundit nuk mund të funksionojnë pa mbështetje. Në rastet kur programet ofrohen nga shoqëria civile dhe shoqëria civile zotëron burimet e nevojshme, rezultati është maksimal.

---

\* Shënim i Përkthyesit- “*tabletop exercise*” janë takime ku diskutohet një situatë e simuluar emergjente.

***Parimi # 10: Konsideroni integrimin e studiuesve (mësuesve) të duhur dhe ekspertëve të tjerë në procesin e riintegrit.***

Studiuesit, duke përfshirë ekspertët fetarë, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e riintegrit. LHT-të e rikthyer të cilët citojnë fenë për veprimet e tyre mund të kenë njohuri të pakta ose një perceptim të manipuluar të fesë në të cilën ata besojnë të jenë frymëzuar.

Inkurajimi i studiuesve të trajnuar siç duhet për t’u angazhuar në dialogje të gjera me LHT-të mund të ngrejë dyshime në lidhje me pikëpamjet e LHT-ve mbi pranueshmërinë e përdorimit të dhunës. Duke qenë se këta studiues mund të bëhen objektiva për terroristët, shtetet duhet të ndër marrin hapa për të garantuar sigurinë e tyre gjatë këtij procesi. Demaskimi dhe kundërshtimi i supozimeve fetare të udhëheqësve të respektuar fetarë mund të përbëjë hapin e parë në procesin e riintegrit.

***Parimi # 11: Caktoni bashkëbiseduesin më të përshtatshëm për një LHT të rikthyer; siguron që bashkëbiseduesit të marrin trajnim të specializuar dhe të koordinojnë aktivitetet e tyre në mënyrë të ngushtë me profesionistët e riintegrit.***

Kontakti pozitiv fillestar me autoritetet është jashtëzakonisht i rëndësishëm në përpjekjet për riintegrim. Vlerësoni LHT-të e rikthyer duke përfshirë intervistat ballë për ballë, për të ndihmuar në caktimin e bashkëbiseduesit më të përshtatshëm. Trajtoni të gjithë pjesëmarrësit në mbledhjen e informacionit dhe teknikat e duhura të intervistimit. Njohja e historikut, nxitësve dhe mundësuesve të LHT-ve dhe moderatorëve që çuan në radikalizimin e tyre, përvoja (ose mungesën e saj) në fushën e betejës, apo ideologjia aktuale qeverisëse mund të identifikohen dhe analizohen në mënyrë sistematike dhe metodike. Ekzekutuesit e ligjit mund të kryejnë biseda të rregullta vullnetare me LHT-të dhe familjarët e tyre, për të treguar shqetësimin e tyre lidhur me mirëqenien e LHT-ve. Është megjithatë e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet këtyre bisedave dhe të bëhen pyetje për qëllime të mbledhjes së informacionit. Si një qasje e shumë agjencive, ekzekutuesit e ligjit mund të mbështesin shërbimet socio-parandaluese, si dhe të qëndrojnë të fokusuar në qëllimet e tyre të sigurisë.

***Parimi # 12: Përfshirja e viktimave dhe e zërave pozitive në programet e riintegrit.***

Viktimat e dhunës terroriste mund të jenë zëra të fuqishëm brenda programeve të riintegrit, sikundër janë prindërit, sidomos nënat, ose vëllezërit e motrat që kanë humbur një të dashur në një akt terrorist. Nëse kryhet si duhet, mund të mundësohet kontakti mes viktimave dhe LHT-ve. Kjo mund të

kontribuojë në mirëqenien fizike dhe psikologjike të viktimave dhe ndoshta në përmirësimin e mirëqenies fizike dhe psikologjike të LHT-ve. Kjo mund të kontribuojë gjithashtu në përmbyesjen e procesit të dehumanizimit përmes të cilit ekstremistët e dhunshëm shpesh kërkojnë të legjitimojnë dhunën kundër atyre që ata perceptojnë si "tjetri". Me anë të ritregimit, viktimat mund të tregojnë pasojat e veprimeve terroriste dhe të demonstrojnë imoralitetin e tyre, gjë që mund të bëjë që LHT-të të vënë në pikëpyetje besimet dhe supozimet e tyre kryesore. Për më tepër, dialogu midis LHT-ve, viktimave dhe mbrojtësve të tyre mund të ulë tensionin psikologjik dhe mund të kontribuojë në riintegrimin e suksesshëm të një LHT-je. Është e rëndësishme të shihet me kujdes kur, si, dhe cilat viktima përfshihen, në mënyrë që LHT-të të jenë më të hapur ndaj mesazheve të tyre dhe, esencialisht, të minimizohet çdo efekt i mundshëm anësor negativ për viktimat.

***Parimi # 13: Ish ekstremistët e dhunshëm mund të jenë të ndikueshëm tek ata që i nënshtrohen procesit të riintegrit.***

Dëshmi të ish ekstremistëve dhe mbështetësve të cilët janë rikthyer nga terrorizmi mund të jenë teste të fuqishme të një ideologjie të gabuar, dhe do të mund të përfshihen në dialogje të riintegrit. Ekstremistët e reformuar, veçanërisht ata që kanë kaluar në një proces riintegrit, mund të kenë ndikim në LHT-të e rikthyer të cilët marrin pjesë në këto programe. Ish ekstremistët e dhunshëm duhet të zgjidhen me kujdes para përfshirjes së tyre në programet e riintegrit. Duke qenë se ish ekstremistët mund të bëhen objektiva për hakmarrje të dhunshme, shtetet duhet të ruajnë sigurinë e tyre gjatë këtij procesi. Si në shumicën e hapave të një procesi riintegrit, marrja e ndihmës dhe përfshirja e komunitetit të një LHT-je për të rekrutuar një ish LHT ose ekstremist mund të zvogëlojë shanset e recidivizmit.

***Parimi # 14: Anëtarët karizmatik të komunitetit mund të ndihmojnë në frymëzimin e ndryshimeve.***

Personat e famshëm dhe personalitete të tjera me ndikim të një komuniteti gjithashtu mund të ndihmojnë në frymëzimin e ndryshimit tek LHT-të e rikthyer. Duhet menduar se cilat audiencë synohen nga grupet e dhunshme ekstremiste për radikalizim, dhe se cilët mund të jenë modele alternative të roleve për këtë sektor. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, integrojnë anëtarët përkatës të komunitetit në programe të riintegrit. Duke qenë se ata më pas mund të bëhen objektiva për hakmarrje të dhunshme, ndërmerri hapa për të garantuar sigurinë e tyre gjatë këtij procesi.

#### **D. Komponentët e Riintegrit**

***Parimi # 15: Përfshirja e programeve të aftësive njohëse në përpjekjet për riintegrit.***

Zhvillimi i programeve njohëse që ndihmojnë shkelësit në përcaktimin e problemeve që i shtynë ata drejt sjelljeve të dhunshme ekstremiste dhe, më pas, në formulimin e objektivave dhe identifikimin dhe zbatimin e zgjidhjeve. Programet njohëse mund të rrisin aftësi të tilla si logjikën dhe arsyetimin, kujtesën dhe zotërimin, përmirësimin e mënyrës në të cilën një LHT përpunon stimujt e trurit, dëgjimit, dhe stimujt vizualë. Këto aftësi ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve, të mësuarit në mënyrë më efikase, dhe të kuptuarit e koncepteve të reja, të cilat mund të inkurajojnë të menduarit kritik për të sfiduar tregimet e radikalizuara të cilat ndryshe mund të çojnë në recidivizëm.

**Parimi # 16: Programet e riintegrit mund të përfshijnë kurse të arsimit bazë, trajnime të aftësive profesionale dhe asistencë në punësim.**

Ndërhyrjet duhet të jenë të bazuara në dëshmi, t'iu përgjigjen drejtpërdrejt këtyre faktorëve të cilët vlerësohen t'a bëjnë një LHT, një individ më të prekshëm ndaj angazhimit në ekstremizëm të dhunshëm. Përmirësimi i edukimit të një LHT-je të rikthyer mund të rrisë vetë-vlerësimin e tyre, vetë-besimin, mundësitë, dhe statusin brenda komuniteteve të tyre. Programet profesionale duhet të plotësojnë ato arsimore dhe të lidhen me llojin e vendeve të punës të disponueshme në rajonet ku LHT-të jetojnë. Qeveritë mund të inkurajojnë shoqërinë civile dhe institucionet qeveritare për të siguruar mundësi akademike, aftësi trajnime, programe të rivendosjes së komunitetit ose trajnime të tjera. Krijimi i ndërlidhjeve ndërmjet programit të një shteti dhe shërbimeve të punësimit të tij mund të ndihmojë në gjetjen e aftësive profesionale të një LHT-je për tregun e punësimit në komunitetin dhe shtetin e tij. Në faza të ndryshme të programit, LHT mund të kërkohet të vërtetojë se plotëson kërkesat e caktuara arsimore, profesionale, të vlerësimit dhe përvojës si një parakusht për marrjen e tij në punë ose mundësi të tjera zhvillimore. Nëpërmjet certifikatave apo ceremonive të diplomimit njihet arritja e LHT-ve të cilët me sukses kanë përfunduar programe të arsimit dhe aftësimit profesional. Megjithatë, ekziston rreziku i ofrimit të një mbështetjeje “të tepruar” ndaj LHT-ve, duke krijuar kështu ndjesinë që LHT-të në një farë mënyre përfitojnë nga qëndrimi i tyre mbi rikthimin.

**Parimi # 17: Prezantimi i mekanizmave të veçantë në lidhje me komunikimin e LHT-ve të rikthyer.**

Nëpunësit shtetërorë duhet të marrin në konsideratë kufizimin e kontakteve ndërmjet popullsisë së përgjithshme dhe LHT-ve të rrezikshëm apo të dhunshëm ekstremistë. Nëpunësit shtetërorë mund të kontrollojnë komunikimin e LHT-ve të rikthyer me persona jashtë vendit apo vizitorë që vijnë në vend, por duhet të shmangin paragjykimin e të drejtave të mbrojtjes ligjore të një LHT-je. Ky monitorim mund të zbatohet për vizitorët familjarë, telefonatat, postën ose email-et. Nëpunësit shtetërorë do të duan të zbulojnë, pengojnë dhe të prishin të gjitha komunikimet nga të cilat do të përfitonin objektivat e terroristëve. Është e rëndësishme që kufizimet të jenë në përputhje me nivelin e kërcënimit dhe të drejtës së brendshme dhe ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Të gjitha vendet duhet të zbatojnë këto masa në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, në përputhje me shtetin e së drejtës, dhe të kuptohen publikisht dhe gjerësisht si të zbatuara në këtë mënyrë.

**Parimi # 18: Përdorimi i stimujve të duhur për LHT-të e rikthyer të cilët marrin pjesë në programet e riintegrit.**

Përfshirja e stimujve për LHT-të e rikthyer të cilët i nënshtrohen programeve të riintegrit mund të ndihmojë në shtyrjen e individëve drejt sjelljeve më pro-sociale dhe të lehtësojë tranzicionin e tyre në shoqëri. Stimujt duhet të konsiderohen me kujdes dhe të jepen me kujdes të madh dhe nuk duhet të ngatërrohen me shpërblimin e një LHT-je të rikthyer për pjesëmarrjen e tyre në një konflikt të huaj. Për shembull, mbështetja mund të jetë në formën e një strehimi më të mirë për familjen e një LHT-je të rikthyer. Shtetet mund të konsiderojnë heqjen e stimujve në rastet e

shkeljeve të rregullave dhe kodeve të sjelljes ose në rast se ka dëshmi të përfshirjes në veprimtari kriminale.

***Parimi # 19: Zhvillimi i programeve të përkujdesjes së mëtejshme, duke punuar në partneritet të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetet.***

Zhvillimi i programeve të fuqishme, individuale, dhe efektive të përkujdesjes së mëtejshme për të lehtësuar tranzicionin, demonstroi vullnetin e mirë të vazhdueshëm, dhe siguron një strukturë të rëndësishme mbështetjeje. Metoda holistike duhet të përfshijë agjenci të shumta, koordinim të kujdesëshëm dhe bashkëpunim midis pjesëmarrësve. Ajo duhet të përfshijë ekzekutues të ligjit, punonjës të shoqërisë civile, dhe punëtorë të shërbimit social, të cilët shkëmbejnë informacione në intervale të rregullta me LHT-të e rikthyer, familjet e tyre, si dhe komunitetin e gjerë. Mentorët mund të jenë kontribues të rëndësishëm në programet e kujdesit të mëpasshëm. LHT që rikthehen do të mund të mbikëqyren nën kushte të rrepta me fokus në këshillimet individuale që ofrojnë, ndër të tjera, një perspektivë për një të ardhme më të mirë. Shtetet gjithashtu mund të dëshirojnë të marrin në konsideratë dënimet alternative, duke qenë se mund të jetë e vështirë ose e pamundur nisja e një rasti të besueshëm ligjor kundër tyre me shumicën e ngjarjeve të ndodhura në një zonë konflikti në një shtet tjetër.

***Parimi # 20: Ofrimi i masave mbrojtëse në rastet e informacionit të besueshëm se një ekstremist i reformuar i dhunshëm përballet me kërcënime për jetën e tij / saj, apo në jetën e anëtarëve të familjes.***

Disa LHT të rikthyer mund të jenë në rrezik hakmarrjeje gjatë tranzicionit të tyre në shoqëri. Duhet të bëhen përpjekje për të përcaktuar nëse individit/ët apo anëtarët e familjes së tij / tyre përballet me "kërcënime për jetën". Ku ekzistojnë rreziqe të tilla, duhet që LHT-të dhe familjet e tyre të zhvendosen në zona më të sigurta. LHT-të dhe anëtarët e familjes së tyre mund të këshillohen mbi masat parandaluese të sigurisë dhe praktikën e sigurisë të hartuara për të zvogëluar rreziqet e ardhshme. Është gjithashtu e rëndësishme të mbahet mend se në qoftë se një LHT percepton se nuk ekziston e drejta e rikthimit të sigurt, kjo mund të shërbejë si një dekurajim për të që të shpëtohet nga ky qëllim.

***Parimi # 21: Monitorimi formal apo informal pas riintegrit mund të jetë një metodë efektive për të parandaluar recidivizmin.***

Pasi një LHT i rikthyer të ketë përfunduar një program riintegrimi dhe pasi është kryer vlerësimi për të përcaktuar se ata përbëjnë pak ose aspak rrezik për komunitetin e gjerë, konsideroni t'i përfshini këta individë në një program monitorimi për sjelljen e tyre. Këto programe variojnë nga menaxhimet aktive të rasteve nga ana ekzekutuesve të ligjit deri në menaxhimin e rasteve nga mosekzekutuesit e ligjit. Mbikëqyrja e ngushtë dhe udhëzimet mund të mbështesin dhe përforcojnë riintegrimin. Monitorimi mund të sigurojë të dhëna të cilat mund të përdoren për të matur efektivitetin e programit të riintegrit. Monitorimi mund të marrë formën e mentorimit, me përdorimin e teknikave efektive të tilla si të folurit e gjuhës së LHT-së në një kuptim të ndjeshëm dhe kulturor, si dhe ndërtimin e besimit. Mentorët duhet të kontrollohen, të kenë rregulla dhe udhëzime të qarta, të marrin të gjithë trajnimet e nevojshme, dhe të kenë qasje për të mbështetur një LHT, siç kërkohet.



***Parimi # 22: Integrimi i familjeve dhe i qarqeve të brendshme me ndikim në programe riintegruese dhe nxitja e një mjedisi komuniteti mikpritës dhe pozitiv.***

Përfshirja e familjeve në programet e riintegritit. Fuqizimi i familjeve dhe i komuniteteve për të krijuar një rrjet të fortë rreth një LHT-je të rikthyer. Rekrutimi i një grupi për të krijuar një plan angazhimi komuniteti për të marrë miratimin e të gjithë palëve të interesuara dhe për të arritur të gjitha aspektet e një grupi të caktuar të komunitetit. Ky grup mund të përfshijë familjet e LHT-ve, anëtarë të organizatave të shoqërisë civile, të shërbimeve sociale, agjencitë e ekzekutimit të ligjit, grupet e veprimit të komunitetit, dhe të tjerë. Ofrimi i mbështetjes për familjet mund të sigurohet veçmas ose brenda një grupi, të tillë si një grup i prindërve, apo një grup i nënave / baballarëve, apo në kombinim. Mjete të tjera të mbështetjes mund të jenë linja të drejtpërdrejta, këshillime, apo forume brenda të cilave bëhet lidhja me familjet e tjera të LHT-ve. Trajnimi mund të ofrohet për komunitetet në zbulimin e shenjave të radikalizimit; kjo mund të përfshijë edhe trajnimin e mediave sociale. Inkurajimi i anëtarëve të komunitetit për të kryer monitorim informal dhe / ose këshillim mund të zvogëlojë mundësinë e recidivizmit. Nëse është e mundur, dhe situatat e garantojnë atë, mbështetja e familjes mund të fillojë ndërsa një LHT është ende në një zonë lufte, e cila do të ndihmonte agjencitë përkatëse në zhvillimin e marrëdhënieve me familjet dhe komunitetet, si dhe do të ndihmojë në njoftimin se kur LHT planifikon të rikthehet.

**Konkluzion: Ngritja e kapaciteteve**

Këto parime mund të shërbejnë për të ofruar udhëzime në zhvillimin e zgjidhjeve të bazuara në komunitet për fenomenin e njerëzve që rikthehen në shtëpi pas angazhimit të tyre në konflikte të dhunshme jashtë vendit. Parimet e përshkruara në këtë dokument kanë për qëllim të informojnë dhe udhëzojnë shtetet ndërsa ata zhvillojnë programe të hartuara për riintegrimin e LHT-ve të rikthyer, dhe ndërsa ata adresojnë problemet më të përgjithshme në lidhje me radikalizimin në komunitetet e tyre. Ato nuk janë hartuar si një listë gjithëpërfshirëse apo ekskluzive e veprimeve dhe duhet të përshtaten për t'iu përgjigjur mjedisit kulturor dhe politik në vende të ndryshme, si dhe të përfshijnë një vlerësim realist të burimeve të disponueshme të aktorëve shtetërorë.

Zhvillimi i programeve të riintegritit kërkon burime, pasi ndër shpenzimet e tjera, ato mund të kërkojnë ndërtimin e partneritetit, bashkëpunimit dhe kooperimit, si dhe trajnim adekuat për profesionistët e përfshirë. Instituti Ndërkombëtar i Drejtësisë dhe i Shtetit të së Drejtës dhe Qendra e Ekselencës Hedayah janë duke zhvilluar programe për të zgjeruar bazën e njohurive rreth kësaj çështjeje. Ne kemi zhvilluar dy programe 5-ditore për të ndihmuar kombet të përballen me sfidat që lidhen me këtë çështje.

Kursi Bazë për Kombet është menduar për zyrtarët e qeverisë dhe është projektuar për t'iu ndihmuar ata të identifikojnë individë nga departamentet dhe agjencitë në vendin e tyre të cilët janë të pozicionuar për të zhvilluar programe të riintegritit nëpërmjet një metode "gjithë qeverisëse". Kursi është i bazuar në këto 22 parime dhe siguron një forum ku pjesëmarrësit do të diskutojnë dhe nxjerrin opsionet e mundshme. Qëllimi është që ata të zgjedhin individët që do të ndjekin kursin e dytë, Kursin Bazë për Praktikuesit, i cili i ndihmon këta të fundit në zhvillimin e programeve të riintegritit që do të funksionojnë në komunitetet e tyre. Kursi Bazë për Praktikantët synon të ndërtojë kapacitetet duke prezantuar ide që mund të çojnë në zgjidhje praktike të cilat mund të zbatohen nga pjesëmarrësit. Ai gjithashtu përfshin një seancë mbi zhvillimin e projektit. Me përdorimin e këtyre parimeve si një udhëzues, pjesëmarrësit do të dalin nga ky kurs me një sërë veprimesh dhe sugjerimesh për programet dhe politikatat e riintegritit, të përshtatura për vendin e

tyre dhe të gatshme për t'jua prezantuar ato zyrtarëve të tyre më të lartë qeveritarë.